

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJETLLËS KANALIZIME LUSHNJE SH.A**

Nr. _____ Prot.

Lushnjë, më _____.2025

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit:

“Pjesë këmbimi Automjete”. Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash- **34330000-9**

Vlera e fondit limit: 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Fondi limit është llogaritur nga grupi i punës duke iu përmbajtur dispozitave të nenit 35 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 76 pika 1.b të V.K.M. nr 285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Adresa : Lgj.18 Tetori, Rr. Vath Korreshi, pranë ish-parkut të mallrave

E-mail : kontakt@ukl.al ;

NIPT : [M24606401K](https://npt.al/M24606401K)

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022,2023,2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 %** e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet është në përpjesëtim dhe e lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, bazuar kjo në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. neni 43, pika 6.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM –së Nr.992, datë 29.12.2014 “Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Adresa : Lgj.18 Tetori, Rr. Vath Korreshi, pranë ish-parkut të mallrave

E-mail : kontakt@ukl.al ;

[NIPT : M24606401K](#)

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet/mallrat e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vertetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose / dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke qënë se procedura e përzgjedhur është procedurë “E Hapur e Thjeshtuar” dhe bazuar tek e VKM Nr.285 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dt 19.05.2021, i ndryshuar; neni 55, pika 4, ku shprehimisht thuhet: “Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm”. Për këtë arsye u vendos që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **20%** të vlerës së fondit limit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë nga QKB për prodhimin ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore me Kod VII.3.B.1 “*Dëshmi të aftësisë profesionale*”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duhet të disponojë personelin kryesor si më poshtë:

- | | |
|---|----------------|
| - Drejtues teknik(i cili duhet të jetë Ing. Mekanik ose Teknik) | 1 (një) |
| - Mekanikë automjetesh (dy) | Jo më pak se 2 |
| - Elektroauto | 1 (një) |
| - Pompist | 1 (një) |

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë ose certifikatë
- Kontratë të rregullt pune

Kriteri i mësipërm konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9)**

Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentat provuese për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt prokurimi duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 5 (pesë) persona, vërtetuar me:

- a) Vërtetim të leshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit, të konfirmuara nga organet përkatëse.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9).***

Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor do të kërkojë nga OE fitues të paraqesë për fuqinë punëtore dokumentacionin (origjinal ose kopje të noterizuar) të sipërcituar.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur sipas shërbimit konkret që kërkohet dhe punonjësve specialist që nevojiten dhe që janë kërkuar për këtë shërbim. Gjykohet se **5 (pesë) punonjës** janë të mjaftueshëm për realizimin me sukses të shërbimit, objekt kontrate.

2.3.5 Certificate ISO 9001:2015, “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” (**ose ekuivalente**) (e vlefshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Çertifikata e mesiperme kerkohet nga autoriteti kontraktor SHRUK Lushnje Sh.a per te vertetuar se malli objekt prokurimi i ploteson kerkesat e cilesise nepermjet certifikatave te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

2.3.6 Certificate ISO 14001:2015, “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” (**ose ekuivalente**) (e vlefshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Çertifikata e mesiperme kerkohet nga autoriteti kontraktor SHRUK Lushnje Sh.a per te vertetuar se malli objekt prokurimi i ploteson kerkesat e cilesise nepermjet certifikatave te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Makineri/Pajisje	Sasia	Gjendja
	Mjetet ngritëse ose transportuese mbi 3 ton si: -karrotrec; -rimorkiator ;	Copë 1	Pronësi ose me qera

Për te vertetuar permbushjen e këtij kriteri, për mjetet e mesiperme duhet te paraqitet:

a) dokumentacion për mjetin në pronësi/me qera/huapërdorje (fatur blerje/ dokumente zhdoganimit/kontrate qiraje/ kontrate huapërdorje/ kontrate dhurimi/çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit të sendit sipas Kodit Civil).

b) Leje qarkullimi të mjetit, police sigurimi, certifikate kontrolli teknik, taksa vjetrore.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9).

Në çdo rast, përpara se të japë kontratën Autoriteti Kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është bërë përlllogaritja në bazë të zërave të preventivit.

2.3.8 OE Ofertues duhet:

1. Të paraqesë një Vetëdeklarim, ku merr përsipër transportin e mjeteve deri në servisin e vet dhe anasjelltas.
2. Të paraqesë një Vetëdeklarim, ku merr përsipër se garancia e mallit do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Argumentimi: Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 41, pika 8: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*

- Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:
Pjesët e kembimit duhet të jenë sipas llojit të përcaktuar në preventiv dhe të përgjigjen standarteve përkatëse.
- Të jenë të reja.
- Të kenë të stampuar tipin e mjetit, të cilit i përket ose ekuivalentin.

➤ **Kërkesa të përgjithshme**

Operatori ekonomik, që do të kryej riparimin e mjeteve, duhet të plotësojë edhe kërkesat e përgjithshme të mëposhtme:

- Punimet e riparimit do të kryhen në mënyrë periodike sipas kërkesave të SHRUKL
- Radha e riparimit të automjeteve të bëhet me miratimin e personave përgjegjës.
- Për zera të defekteve të parashikuara të cilat nuk ndodhen në listën ofertën e riparimeve do të negociohet me Operatorin Ekonomik, brenda limitit të shumës së fondit.
- Çmimet e zerave të riparimeve duhet të përfshijnë dhe koston e shërbimit .
- Riparimet xhenerike të pjesshme të përfundojnë brenda ditës, ndërsa punimet xhenerike të plota të përfundojnë brenda një jave.
- Në përfundim të riparimit, automjetit të merret në dorëzim mbasi bëhet provë në presence të grupit të monitorimit të kontratës.

Riparimi i deshtuar para afatit të garancisë, përshkak të cilës së dobët të punimeve, do të ribëhet pa pagesë nga ana e Operatorit Ekonomik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është bërë përlllogaritja në bazë të zërave të preventivit.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në varësi të natyrës së shërbimit që kërkohet, të cilat gjykohet se janë të nevojshme dhe të rëndësishme për mbarëvajtjen me sukses të kontratës.

Kriteret e kualifikimit janë vendosur në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës me qëllim që të vërtetohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet ligjore dhe kualifikimet e nevojshme teknike e profesionale si edhe pervojën e duhur për përmbushjen me sukses të kontratës, objekt i këtij prokurimi, e cila ka një specifikë të vecantë.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njësisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe Formulari Përmbledhës i Njoftimit të Kontratës, do i paraqitet Titullarit të Autoritetit Kontraktor për tu nënshkruar dhe u ra dakort që të hidhen në Sistemin Elektronik të Prokurimit për publikim dhe shpallje nga APP.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.